

NDREQJE GABIMI

1. Në vendimin nr. 10, datë 6.12.2013 të Bordit të Komisionerëve “Mbi kërkesën e shoqërisë KESH sh.a. për rinovimin e licencës në aktivitetin e furnizuesit publik me shumicë”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 21, datë 3.3.2014, faqe 481, bëhet korrigjimi si më poshtë:

Ishte: Vendimi nr. 10, datë 6.12.2013 “Mbi kërkesën e shoqërisë KESH sh.a. për rinovimin e licencës në aktivitetin e furnizuesit publik me shumicë”

Bëhet: Vendimi nr. 10, datë 6.2.2014 “Mbi kërkesën e shoqërisë KESH sh.a. për rinovimin e licencës në aktivitetin e furnizuesit publik me shumicë”.

2. Në vendimin nr. 60, datë 7.7.2014 të Bordit të Komisionerëve, “Mbi kërkesën e shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a. për rishikimin e vendimit nr. 9, datë 6.2.2014 mbi një shtesë në rregulloren “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij, në zbatim të nenit 18, pika 4/c të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 126, datë 11.8.2014, faqe 5828, bëhet korrigjimi si më poshtë vijon:

Ishte: Në vendimin nr. 60, datë 7.7.2014 “Mbi kërkesën e CEZ Shpërndarje sh.a. për rishikimin e vendimit nr. 90, datë 6.2.2014, mbi një shtesë në rregulloren “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij, në zbatim të nenit 18, pika 4/c të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Bëhet: Mbi kërkesën e shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a. për rishikimin e vendimit nr. 9, datë 6.2.2014, mbi një shtesë në rregulloren “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij, në zbatim të nenit 18, pika 4/c të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe propozimit “Për rishikimin e rregullave dhe procedurave të blerjes së energjisë nga KESH sh.a.”

3. Gjithashtu në vendimin nr. 60, datë 7.7.2014 të Bordit të Komisionerëve, “Mbi kërkesën e shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a. për rishikimin e vendimit nr. 9, datë 6.2.2014 mbi një shtesë në rregulloren “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij, në zbatim të nenit 18, pika 4/c të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 126, faqe 5828, në pjesën referuese të bazës ligjore të bëhet ndryshimi si më poshtë:

Ishte: Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike, të ndryshuar dhe nenit 26 të rregullore të praktikës dhe procedurave të ERE-s, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) në mbledhjen e tij të datës 7.7.2014, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Teknike, lidhur me kërkesën e shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a. për rishikimin e vendimit nr. 9, datë 6.2.2014, “Mbi një shtesë në rregulloren “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij, në zbatim të nenit 18, pika 4/c të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”

Bëhet: Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike, të ndryshuar dhe nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) në mbledhjen e tij të datës 7.7.2014, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Teknike, lidhur me kërkesën nr. 3277 prot. datë 20.3.2014 të shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a. për rishikimin e vendimit nr. 9, datë 6.2.2014 “Mbi një shtesë në rregulloren “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij, në zbatim të nenit 18, pika 4/c të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe propozimit të CEZ Shpërndarje sh.a. “Për rishikimin e rregullave dhe procedurave të blerjes së energjisë nga KESH sh.a.”.

